



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 3.5 pika (ii), 15.1 pika (a), (d), (e) dhe (j), 21.2, 32, 33, 50, 55 dhe 56 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Viti III, Nr. 28, datë 4 qershor 2008),

Duke marrë parasysh,

Obligimet ndërkombëtare të Republikës së Kosovës në lidhje me Marrëveshjen Shumëpalëshe për Themelimin e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (me tutje referuar si "Marrëveshja për HPEA") që nga hyrja e saj e përkohshme në fuqi për Kosovën më 10 tetor 2006;

Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2009 të datës 30 tetor 2009, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, të datës 20 shkurt 2008 për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e Agjencisë Evropiane për Sigurinë në Aviacion,

Rregulloren e AAC-së Nr. 6/2009 të datës 9 nëntor 2009, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, Rregulloren e Këshillit (EEC) Nr. 3922/91, të datës 16 dhjetor 1991 mbi harmonizimin e kërkesave teknike dhe procedurave administrative në fushën e aviacionit civil,

Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2010 të datës 10 tetor 2010, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, Kërkesat e Përbashkëta të Autoriteteve të Aviacionit dhe Procedurat Administrative të Aplikueshme në Transportin Ajror Komercial - Helikopterët, Kërkesat e Përbashkëta të Aviacionit (JAR-OPS3) të adoptuara nga Autoritetet e Përbashkëta të Aviacionit (JAA).

Rregulloren e AAC-së Nr. 9/2011 të datës 28 shtator 2011, mbi Vlerësimin e Sigurisë së Mjeteve Ajrore të Huaja (SAFA), kualifikimet e inspektoreve SAFA dhe krijimin e listës së Kompanive Ajrore që janë subjekt i ndalimit të operimit brenda territorit të Republikës së Kosovës, e cila zbaton në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës, Direktivën 2004/36/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 21 prill 2004 mbi sigurinë e mjeteve ajrore të vendeve të treta të cilat përdorin aeroportet e Komunitetit; Rregullorja e Komisionit (EC) Nr. 768/2006 e datës 19 maj 2006 e cila zbaton Direktivën 2004/36/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me mbledhjen dhe shkëmbimin e informatave mbi sigurinë e mjeteve ajrore të cilat përdorin aeroportet e Komunitetit dhe menaxhimin e sistemit të informatave; Direktivën e Komisionit 2008/49/EC të datës 16 prill 2008, e cila ndryshon Aneksin II

të Direktivës 2004/36/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me kriteret për kryerjen e inspektimeve të mjeteve ajrore në platformë të cilat përdorin aeroportet e Komunitetit; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 351/2008 të datës 16 prill 2008 e cila zbaton Direktivën 2004/36/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me prioritetin e inspektimeve në platformë për mjetet ajrore të cilat përdorin aeroportet e Komunitetit; Rregulloren (EC) Nr. 2111/2005 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 14 dhjetor 2005 për krijimin e listës së Komunitetit të Operatorëve Ajror të cilët janë subjekt i ndalimit të operimeve brenda Komunitetit dhe mbi informimin e pasagjerëve të transportit ajror mbi identitetin e transportuesit ajror i cili operon dhe shfuqizimin e Nenit 9 të Direktivës 2004/36 / EC; Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 473/2006 e datës 22 mars 2006 e cila parashton rregullat zbatuese për listën e operatorëve ajrorë të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit të referuar në Kapitullin II të Rregullores (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, si dhe Rregulloren e Komisionit (EC) Nr. 474/2006 e datës 22 mars 2006 për krijimin e listës së Komunitetit të Transportuesve Ajror të cilët i nënshtrohen ndalimit të operimeve brenda Komunitetit të referuar në Kapitullin II të Rregullores (EC) Nr. 2111/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit,

Me qëllim të zbatimit të Rregullores së Komisionit (EU) Nr. 965/2012 të datës 5 tetor 2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të ndryshuar me Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 800/2013 të datës 14 gusht 2013; Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 71/2014 të datës 27 janar 2014; Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 83/2014 të datës 29 janar 2014; Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 379/2014 të datës 7 prill 2014 dhe Rregulloren e Komisionit (EU) 2015/140 të datës 29 janar 2015, në rendin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 4/2015
QË PËRCAKTON KËRKESAT TEKNIKE DHE PROCEDURAT ADMINISTRATIVE
NË LIDHJE ME OPERIMET AJRORE

Neni 1

1.1 Kjo Rregullore përcakton rregullat e detajuara të operimeve ajrore me aeroplanë, helikopter, balon dhe planer, duke përfshirë inspektimet në platformë të mjeteve ajrore të operatorëve nën mbikëqyrje të sigurisë nga një shtet tjetër, kur aterrojnë në aerodromet brenda territorit të Republikës së Kosovës.

1.2 Kjo Rregullore gjithashtu përcakton rregullat e detajuara për kushtet e lëshimit, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin apo revokimin e certifikatave të operatorëve të mjeteve ajrore të referuar në Nenin 4(1) (b) dhe (c) të Rregullores (EC) Nr. 216/2008 të përfshirë në operime të transportit ajror komercial, privilegjet dhe përgjegjësitë e mbajtësve të certifikatave, si dhe kushtet në të cilat operimet do të ndalohen, kufizohen apo nënshtrohen kushteve të veçanta në interes të sigurisë.

1.3 Kjo Rregullore gjithashtu përcakton rregullat e hollësishme për kushtet dhe procedurat për deklarimin, si dhe mbikëqyrjen e operatorëve të angazhuar në operime të specializuara komerciale dhe operime të mjeteve ajrore me motor kompleks jo-komerciale, duke përfshirë operimet jo-komerciale të specializuara të mjeteve ajrore me motor kompleks.

1.4 Kjo Rregullore gjithashtu përcakton rregullat e hollësishme të kushteve të veçanta sipas të cilave operimet komerciale të specializuara me rrezikshmëri të lartë, duhet të jenë subjekt i autorizimit në interes të sigurisë, si dhe kushteve për lëshimin, mbajtjen, ndryshimin, kufizimin, pezullimin apo revokimin e autorizimit.

1.5 Kjo Rregullore nuk aplikohet për operimet ajrore brenda fushëveprimit të Nenit 1(2) (a) të Rregullores (EC) Nr. 216/2008.

1.6 Kjo Rregullore nuk aplikohet për operimet ajrore me balon të lidhur (kufizuar) me kabllo në tokë dhe anije ajrore, si dhe fluturimet me balon të lidhur (kufizuar) me kabllo në tokë.

Neni 2

2.1 Rregullorja e Komisionit (EU) Nr. 965/2012 e datës 5 tetor 2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, e ndryshuar me:

- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 800/2013 të datës 14 gusht 2013, e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 965/2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 71/2014 të datës 27 janar 2014, e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 965/2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 83/2014 të datës 29 janar 2014, e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 965/2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;

- Rregulloren e Komisionit (EU) Nr. 379/2014 të datës 7 prill 2014, e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 965/2012 që përcakton kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me operimet ajrore, mbështetur në Rregulloren (EC) Nr. 216/2008 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit;
- Rregullorja e Komisionit (EU) 2015/140 të datës 29 janar 2015, e cila ndryshon Rregulloren (EU) Nr. 965/2012 lidhur me kabinën sterile të ekuipazhit të fluturimit dhe përmirësimin e kësaj Rregulloreje.

me tutje e referuar si "Rregullorja e Komisionit", shpallet e zbatueshme në Republikën e Kosovës. Rregullorja e Komisionit i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje si shtojcë dhe formon pjesën e saj përbërëse.

2.2 Dispozitat e zbatueshme të Rregullores së Komisionit janë nenet 1-9, si dhe Shtojcat I-VIII, ashtu siç janë ndryshuar me rregulloret e përmendura në paragrafin 1.

2.3 Çdo dispozitë e amandamenteve të ardhshme të Rregullores së Komisionit, me futjen e saj në fuqi si pjesë e Shtojcës I ose II të Marrëveshjes për HPEA, do të jetë e zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

Neni 3

3.1 Kuptimi i shprehjeve dhe definicioneve të përdorura në këtë Rregullore janë të përfshira në Nenin 2 të Rregullores së Komisionit.

3.2 Pavarësisht nga paragrafi mësipër, shprehjet "Komuniteti", "Ligji i Komunitetit", "Legjislacioni i Komunitetit", "Instrumentet e Komunitetit", "Traktati i KE", "Aeroporti i Komunitetit", "Gazeta Zyrtare e Komuniteteve Evropiane", "Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian", "Transportues Ajror i Komunitetit" dhe "Shtet(e) Anëtar(e)", të cilat mund të referohen në mënyre të drejtpërdrejt ose tërthorazi në Rregulloren e Komisionit, duhet të lexohen në përputhje me Pikat 2 dhe 3 të Shtojcës II të Marrëveshjes për HPEA.

3.3 Për qëllim të kësaj Rregulloreje shprehja "autoriteti kompetent", "autoriteti i duhur", siç është e referuar në Rregulloren e Komisionit, për organizata të cilat veprimtarinë kryesore të biznesit e kanë në Republikën e Kosovës, do të nënkuptojë Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës; ose "Agjencinë Evropiane të Sigurisë së Aviacionit" (më tutje e referuar si "Agjencia") nëse kjo kërkohet nga Republika e Kosovës.

Neni 4

4.1 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC) dhe Materialet Udhëzuese (GM) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Nr.: Vendimi DE 2012/015/R i datës 24 tetor 2012; Vendimi DE 2014/019/R i datës 24 prill 2014; Vendimi DE 2014/025/R i datës 28 korrik 2014; Vendimi DE 2014/015/R i datës 28

prill 2014; Vendimi DE 2013/021/R i datës 23 gusht 2013; Vendimi DE 2014/016/R i datës 24 prill 2014; Vendimi DE 2014/017/R i datës 24 prill 2014; Vendimi DE 2012/019/R i datës 24 tetor 2012; Vendimi DE 2014/018/R i datës 24 prill 2014, siç mund të ndryshohen, do të zbatohen .

4.2 Specifikimet e certifikimit (CS) të përcaktuara me Vendimet e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Nr.: Vendimi DE 2012/010/R i datës 4 korrik 2012; Vendimi DE 2012/011/R i datës 26 qershor 2012; Vendimi DE 2014/002/R i datës 31 janar 2014; Vendimi DE 2014/004/R i datës 31 janar 2014; Vendimi DE 2014/005/R i datës 31 janar 2014, siç mund të ndryshohen, do të zbatohen..

4.3 Mënyrat e Pranueshme të Përshtatshmërisë (AMC), Materialet Udhëzuese (GM) dhe Specifikimet e Certifikimit (CS) të referuara në paragrafët 4.1 dhe 4.2 janë të publikuara në faqen e internetit të Agjencisë.

Neni 5

Në rast të interpretimit të Rregullores së Komisionit do të përdoret versioni original në gjuhën angleze siç është i publikuar në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Neni 6

Kjo Rregullore shfuqizon Rregulloren e AAC-së Nr. 6/2009 të datës 9 nëntor 2009 mbi Harmonizimin e Kërkesave Teknike dhe Procedurat Administrative në fushën e aviacionit civil; Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2010 mbi Kërkesat e Përbashkëta të Autoriteteve të Aviacionit dhe Procedurat Administrative të Aplikueshme në Transportin Komercial Ajror - Helikopterët (JAR-OPS 3) të datës 10 tetor 2010; Rregulloren e AAC-së Nr. 3/2011 mbi Vlerësimin e Sigurisë së Mjeteve Ajrore të Huaja (SAFA), kualifikimet e inspektoreve SAFA dhe krijimin e listës së Kompanive Ajrore që janë subjekt i ndalimit të operimit brenda territorit të Republikës së Kosovës, të datës 28 shtator 2011 si dhe Rregulloren e AAC-së 2/2012 për Operimet me mjete ajrore mikro të lehta të dt. 10 tetor 2012.

Neni 7

Kjo Rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas nënshkrimit të saj.

Prishtinë, 8 korrik 2015.

Dritan Gjonbalaj
Drejtore i Përgjithshëm